



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosova



Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality



Komuna e Kamenicës - Kuvendi Komunal

Më datë : 29.12.2025

Në bazë të dispozitave të nenit 12, 51 dhe 53 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28, datë 4 qershor 2008, si dhe Udhëzimit Administrativ nr.05/2020 për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e Komiteteve për Komunitete në Komunë, dhe në përputhje me nenet 38, 46, 47, 54, dhe 82 të Statutit Sh.01.Nr.20203, të datës 21.06.2023 të Komunës së Kamenicës, Kuvendi i Komunës së Kamenicës në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datë 29.12.2025 miratoi këtë:

VENDIM

THEMELI I KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA

1. Me këtë Vendim, themelohen Komiteti për Politikë dhe Financa i Kuvendit të Komunës së Kamenicës.
2. Kryesuesi i Kuvendit të Komunës shërben gjithashtu si Kryesues i Komitetit për Politikë dhe Financa.
3. Komiteti ka mandat katërvjeçar.
4. Për anëtarë të Komitetit për Politikë dhe Financa emërohen si më poshtë:
 - 4.1. znj. Arbnore Beqiraj Fera, Kryesuese e Komitetit;
 - 4.2. z. Liridon Kastrati, Anëtar i Kuvendit nga LVV;
 - 4.3. znj. Arlinda Basha, Anëtare e Kuvendit nga LVV;
 - 4.4. znj. Magbule Kastrati, Anëtare e Kuvendit nga PSD;
 - 4.5. z. Labinot Skoverqani, Anëtar i Kuvendit nga AAK;
 - 4.6. z. Jeton Biqkaj, Anëtar i Kuvendit nga LDK; dhe
 - 4.7. z. Granit Berisha, Anëtar i Kuvendit nga PDK.
5. Komiteti për Politikë dhe Financa, në përputhje me nenin 52, paragrafi 52.2 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, ka këto përgjegjësi:
 - 5.1. Të shqyrtojë të gjitha politikat, dokumentet fiskale dhe financiare, planet dhe iniciativat e komunës;
 - 5.2. Të përfshijë në shqyrtim dokumentet e planifikimit strategjik, Kornizën Vjetore Buxhetore Afatmesme, planin vjetor të prokurimit, rregulloren vjetore për tatimet, tarifat dhe pagesat, planin vjetor të punës për auditimin e brendshëm, buxhetin vjetor afatmesëm dhe çdo ndryshim të buxhetit gjatë vitit fiskal;

5.3. Të marrë raportet nga Kryetari i Komunës dhe t'i dorëzojë rekomandimet përkatëse në Kuvendin e Komunës.

6. Ky Vendim hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në faqen elektronike të Komunës së Kamenicës.

Arsyetimi

Baza ligjore e këtij Vendimi përcaktohet nga: Nenet 12, 51 dhe 52 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28, datë 4 qershor 2008; Udhëzimi Administrativ nr.05/2020 për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e Komiteteve të Përhershme në Komunë; Nenet 46, 50 dhe 82 të Statutit Sh.01.Nr.20203 të datës 21.06.2023 të Komunës së Kamenicës.

T'i dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit;
- Zyrës për Informim;
- Zyrës së Personelit;
- Shërbimit të Kuvendit;
- MAPL-së;
- Anëtarëve të Komitetit për Politikë dhe Financa; dhe
- QSHQ – Arkivit.

Kryesuese e Kuvendit

Arbnore Beqiraj Fera

